

Për veprim

24-09-2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 316/3 Prot.

Tiranë, më 24.09 2018

Lënda: *Dërgim rezolute për dijeni*

Drejtuar:

INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojmë për dijeni:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Genci GJONÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e shtetit shqiptar për intensifikimin e ndjeshëm në luftën kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit të vendit dhe anëtarësimin në BE dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasjeje të trefishtë ndërgjegjësuese, parandaluese dhe ndëshkuese;

- Duke theksuar rëndësinë e koordinimit të suksesshëm dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura, duke rritur efikasitetin e hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;

- Duke vlerësuar gjetjet në raportet për Shqipërinë për vitet 2016 dhe 2018 të Komisionit Europian në lidhje me veprimtarinë e kryer nga ILDKPKI, progresin e shënuar në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe planit të saj të veprimit, sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave dhe prioritetëve të ILDKPKI-së, si dhe arritjen e zbatimit të plotë të rekomandimeve të GRECO-s, lidhur me këtë institucion;

- Duke inkurajuar e mbështetur këtë institucion, si organ kyç në luftën kundër korrupsionit, me forcimin e kapaciteteve administrative, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, subjekte të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin dhe garantimin në denoncimin e tyre;

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se për vitin 2017:

1. Performanca e ILDKPKI-së gjatë vitit 2017 ka shënuar rritje të mëtejshme në funksionimin tërësor institucional, lidhur me zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe kërkesave të Kuvendit në rezolutën e fundit të tij për vitin 2016, duke zbatuar të gjithë kuadrin ligjor në fuqi:

a) ligji nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;

c) ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

ç) ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2. ILDKPKI, gjatë vitit 2017, është angazhuar maksimalisht për garantimin e mbarëvajtjes së të gjithë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka vendosur marrëdhënie institucionale me organet e rivlerësimit dhe me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, duke dorëzuar brenda afateve të përcaktuara ligjore raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për subjektet e procesit të rivlerësimit të përfshirë në listën prioritare.

3. ILDKPKI, si organ ndihmës për procesin e rivlerësimit kalimtar, shënon edhe indikatorët e parë të rezultateve të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i ngritur dhe në funksion të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili, në kriterin e parë të rivlerësimit të subjektit, vlerëson pasurinë e tij duke u bazuar, ndër të tjera, edhe në raportin e arsyetuar të ILDKPKI-së.

4. Ka arritur rezultate konkrete lidhur me zbulimin e fshehjeve të pasurisë, si dhe në zbulimin e shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke zbatuar skemën e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, për 1335 subjekte deklaruese.

5. Ka marrë masa ndëshkuese, duke aplikuar në total 436 masa administrative “gjobë” dhe ka depozituar 32 referime penale pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke kërkuar në çdo rast dhe marrjen e masave disiplinore nga institucionet ku zyrtarët shkelës të ligjit kryejnë funksionet publike.

6. Të dhënat e raportit të ILDKPKI-së referojnë nivelin e lartë të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, e cila dyshohet se deri më 31 dhjetor 2017 arrin deri në 80 milionë euro, për të cilën ILDKPKI ka adresuar kallëzimet penale;

7. ILDKPKI, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, ka filluar procesin e ngritjes së sistemit elektronik, të deklarimit të interesave privatë, i ndihmuar nga USAID dhe Këshilli i Europës, së bashku me Bashkimin Europian, duke siguruar mbështetjen e tyre financiare lidhur me zhvillimin e programit të sistemit dhe pajisjet për funksionimin e tij.

8. Ka vijuar zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet kryesore në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe krimit të organizuar, si mekanizma për lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave.

9. Ka marrë masat e nevojshme institucionale, në ushtrim të kompetencës së re ligjore, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” me ngritjen dhe funksionimin e 163 njësive përgjegjëse në sektorin publik dhe 446 në sektorin

privat, si dhe aplikimin e të gjitha instrumenteve dhe kompetencave ligjore, duke raportuar treguesit e parë lidhur me zbatimin e këtij ligji.

10. Ka ndjekur një politikë të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, me trajtimin në përputhje me afatet ligjore të të gjitha kërkesave të paraqitura, duke publikuar rreth 13 419 deklarata të interesave privatë gjatë vitit 2017.

11. Çështjet e regjistrimit, trajtimit, zgjidhjes dhe monitorimit të rasteve të konfliktit të interesave kanë nevojë për përmirësime në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

12. Kuvendi konstaton se shqetësimi për përmbushjen e detyrave funksionale të ILDKPKI-së, në kuadër të kontrolleve dhe hetimeve administrative, mbetet mungesa e aksesit të drejtpërdrejtë në regjistra të ndryshëm publikë, si dhe baza të dhënash, shqetësim ky i evidentuar në mënyrë të posaçme gjatë vitit 2017, në përballimin e fluksit të mbledhjes së të dhënave për subjektet e rivlerësimit, çka ndikoi në procesin e verifikimit dhe trajtimit të çështjeve.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2018, kërkon nga ILDKPKI të ketë në fokus të punës së tij:

- Ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit, si faktorë që ndikojnë në rritjen e rezultateve konkrete në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

1. Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit, duke garantuar me prioritet vijueshmërinë e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (*vetting-un*) në hartimin dhe dërgimin pranë institucioneve të rivlerësimit dhe ONM-së të dokumentacionit të plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ndjekjen dhe zbatimin e skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklaruese, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

3. Zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të njësive përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe realizimin, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, të fushatave ndërgjegjësuere.

4. Forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë.

5. Vazhdimin e ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë.

- Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave të mbështesin institucionin me financime të nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit elektronik, të deklarimit të interesave privatë, me qëllim rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe publikimin e të dhënave në

deklaratat e interesave privatë për konsultim nga publiku, media dhe shoqëria civile apo çdo palë tjetër e interesuar.

- Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave të mundësojnë sigurimin e aksesit të ILDKPKI-së në Sistemin TIMS, si një ndër instrumentet e kontrollit që ndikojnë në rezultatet e hetimit të zyrtarëve subjekt të deklarimit të pasurive dhe interesave privatë.

- Kuvendi dhe ILDKPKI të bashkëpunojnë gjatë vitit 2018 për zbatimin e duhur të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, të miratuar më vendim të Kuvendit nr. 61/2018, duke siguruar këshillim, trajnim dhe udhëzime lidhur me mënyrat e trajtimit të konfliktit të interesit të deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues.

Miratuar në datën 20.9.2018